

Klasa e dytë

1. MËSOJMË MË SHUMË PËR VETEN

Hyrje

Ky kapitull është një rimarrje e njohurive dhe problematikës që trajtohet në klasën e parë mbi “Zbulimin e vetvetes”. Këtu, tashmë, zgjerohet rrethi i koncepteve që duhet të fitojnë fëmijët për të njohur vetveten. Njohja nuk përqëndrohet vetëm në treguesit e ndërtimit fizik të trupit të fëmijës, por dhe në ato emocionale.

1.1 Si të zbuloj diçka më shumë për trupin tim

Objektivat: Në fund të kësaj teme nxënësit:

- Do të emërtojnë saktë pjesët e dukshme të trupit, si dhe organet e brendshme, më të rëndësishme.
- Do të tregojnë, thjesht, lëvizjet apo funksionet e pjesëve të emërtuara.
- Do të flasin për vështirësitë fizike, në individë të veçantë.

Forma pune: Bisedë, bashkëbisedim, punë në grupe.


Mjetet: Fletë të bardha formati, ku është skicuar trupi i njeriut, lapustila me ngjyra.

Organizimi i mësimit:

Hapi i parë

Nxënësit njihen me temën dhe objektivat që do të arrihen në fund. Klasa ndahet në tre grupe.

Grupi i parë: Vendosi në formatin e skicuar pjesët e sipërme të trupit.



- 1) Shpatullat e mia.
 - **Si mund t'i lëviz ato?**
 - Jepen mënyrat e ndryshme të lëvizjes

- 2) Gjoksi im.
- **Çfarë ndodh kur unë marr frymë?** (tregohet konkretisht)
 - **Por kur e nxjerr frymëmarrjen?** (tregohet konkretisht)
 - **Ç'është ajo që rreh në brendësi?** (tregohet konkretisht)
 - Zemra. Ajo punon pa pushim.
- 3) Tek barku kemi edhe stomakun.
- **Ai mund të jetë bosh apo plot, i zbrazët apo i mbushur.**
 - **A na dhemb ndonjëherë ?**

Grupi i dytë: Vendos në formatin e skicuar të gjithë elementët e kokës: sytë, hundën, qerpikët, vetullat, faqet, gojën, buzët, dhëmbët, veshët, flokët; e, në brendësi, kemi trurin.

Ai drejton gjithçka

Grupi i tretë: në formatin e skicuar vendos të gjitha elementët e dorës e të këmbës: Krahët, bërrylin, kyçet, gishtat, vithet, kofshën, këmbën, tabanin e këmbës dhe muskujt.

Në këtë rast, mësuesi, me takt, mund të ndërhyjë për të treguar ndryshimet midis meshkujve e femrave.

Natyrisht, është një argument, në të cilin fëmijet tregohen mjaft kureshtarë. Niveli e sasia e njohurive, që fëmijet kanë për këtë argument, do të jetë i ndryshëm dhe do të varet nga sjelljet e rrethanat në shtëpi, nga egzistenca e vëllëzerve dhe e motrave.

Këshillohet një fjalor i saktë për përshkrimin e pjesëve të trupit.

Më pas nxënësit punojnë me fletën e punës numër 1.

Hapi i dytë

- Deri në ç'pikë mund të kthehem, kur unë jam i ulur?
- Sa kyçe keni në trupin tuaj?
- Si lëvizin krahët e mi? (tregohet duke vepruar)
- Cili është objekti më i vogël që mund të kapni me gishtat e këmbëve?
- Përse veshim këpucë?


Hapi i tretë

Vështirësitë në lëvizje

Disa njerëz nuk mund të lëvizin si të tjerët. Mund të ketë shumë arsye për këtë:

1. Mund të kenë lindur të tillë.
2. Mund të kenë pësuar aksident.
3. Mund ta kenë pasojë të sëmundjeve.

Tani janë krijuar shumë mjete për të ndihmuar këta njerëz që lëvizin me vështirësi, si karroca për të lëvizur, paterica etj.



Vlerësimi

Në fund jepen vlerësimet, në bazë të objektivave të arritura.

1.2 Mësoj edhe më shumë për veten

Objektivat: Në fund të kësaj teme, nxënësit:

- Do të tregojnë qartë parapëlqimet e tyre në lojë, ushqim e veshje.
- Do të shprehen saktë për përvojat e tyre, të cilat u kanë shkaktuar emocione pozitive.

Forma pune: Bisedë, bashkëbisedim e punë në grupe.

Mjetet: Figura të prera nga ushqimet, lodrat, veshjet e kafshët që parapëlqejnë.

Organizimi i mësimit

Hapi i parë

Klasa ndahet në tre grupe dhe secilit grup i jepen detyrat, si më poshtë:

Grupi i parë: Krijon një kolazh me figura të prera, të cilat tregojnë lodrat që u pëlqejnë më tepër. Secili tregon lodrën që i pëlqen dhe si luan më të .

Grupi i dytë: Krijon një kolazh me ushqimet që pëlqen më shumë. Secili thotë, çfarë i pëlqen dhe kur e ha atë.


Grupi i tretë: Shkruajnë gjërat që parapëlqejnë t'i kryejnë vetë. E rëndësishme është që secili argumenton idenë e tij.

Hapi i dytë

1. Pyeten rreth muzikës që pëlqejnë të dëgjojnë.
2. Rrobat që parapëlqejnë të veshin.
3. Tregimet që pëlqejnë të lexojnë.
4. Kafshët që parapëlqejnë të mbajnë pranë.

Hapi i tretë

1. Nxënësve u kërkohet të mendojnë rreth një ngjarjeje të kohëve të fundit, që i ka bërë të lumtur (ditëlindja e fundit, një ftesë e papritur, ndihma që i kanë dhënë dikujt, shpërblimi për një përkujdesje).
2. Ata duhet të flasin lirshëm rreth përvojave të tyre dhe plotësojnë fletën e punës numër 2.



Vlerësimi

Në fund bëhen vlerësimet, sipas aktivizimit të nxënësve në diskutime për arritjen e objektivave.

2. SI KAM LINDUR

Hyrje

Në trajtimin e këtij kapitulli mësuesit do të vërejnë se problematika e trajtuar ka lidhje të ngushtë me njohuritë e dhëna në kapitullin e parë “Zbulimi i vetvetes”, që zhvillohet në klasën e parë.

Në klasën e parë, tashmë, nxënësit kanë marrë njohuri dhe kanë fituar sjellje korrekte për veten dhe trupin e tyre. Kjo sjellje shfaqet në mënyrë të ndryshme. Fëmijët bëjnë shumë pyetje për seksin apo për riprodhimin, etj.

Mësuesit dhe prindërit duan të familiarizohen me zhvillimin seksual të fëmijës, dëshirojnë t’i japin kësaj çështjeje vëmendjen dhe hapësirën e duhur, por ata pyesin veten: si ta bëjnë, çfarë të thonë, në ç’rast, si të reagojnë ndaj një gjëje të tillë?

Prandaj në këtë kapitull, është parë e arsyeshme që të jepet një informacion i bollshëm për mësuesit. Ky informacion duhet të jetë i tillë sepse në gjuhën shqipe, ka mungesa të konsiderueshme të literaturës në këtë fushë. Ky informacion mund të përdoret edhe nga prindërit.

Informacion për mësuesin

Edukimi seksual fillon që në fëmijëri

Edukata seksuale është pjesë organike e edukatës tërësore dhe, si e tillë, ajo fillon që në fëmijëri.

Dihet se që në vogëli formohen pikëpamje të caktuara, të cilat luajnë rol të madh në edukimin e mëvonshëm, përfshirë dhe edukimin seksual.

Prandaj, edhe puna për edukimin seksual duhet të fillojë më parë sesa të formohen dhe të rrënjosen pikëpamje të gabuara dhe, shpesh, të dëmshme për jetën e ardhshme.

A është e mundur, si i rritur, ta njohësh seksualitetin e fëmijës, ta pranosh atë si pjesë përbërëse të jetës së tij, t'i kushtosh vënd aq sa i takon dhe ta kuptosh si burim të rritjes dhe të mirëqenies?

Duhet të dimë se, qëndrimet dhe sjelljet seksuale të fëmijës, tregojnë për një zhvillim, në tërësi, të shëndetshëm, normal dhe të natyrshëm; ata karakterizohen nga nevoja për të zbuluar, kureshtja dhe prirja për të imituar.

Mësuesit dhe prindërit duhet të dinë se fëmijët, gjithmonë, janë të prirur nga dëshira për të zbuluar, njohur dhe përcaktuar interesat e veta, në raport me të tjerët.

Kështu, nëpërmjet lojës, fëmija sigurohet se seksi tjetër është i njëjtë apo i ndryshëm me të tjin. Ky vërtetim, në raport me fëmijët e tjerë, bëhet edhe kur ai ka parë më parë prindërit, vëllezërit apo motrat lakuriq. Përpjekja për hapje ndaj tjetrit realizohet nëpërmjet lojërave seksuale me fëmijët e tjerë. Shpesh këto veprimtari shoqërohen me ngacmime, ku mbizotëron ndjenja e “gjësë së ndaluar”.

Shpesh, fëmijët luajnë lojën “doktorash”; ata angazhohen seriozisht në të gjitha etapat e lojës; për shembull, kur realizojnë gjoja vizitën, dhënien e ilaçeve, ashtu dhe në çastin kur fëmija heq të mbathurat.

Nëse ndërhyjni në lojë apo e ndërprisni atë, mund të përfitoni nga rasti për të bërë edukim seksual, duke përcaktuar me fëmijët zbulimet që kanë bërë, duke i siguruar ata se kureshtja e tyre është normale, duke i siguruar për qëndrimin tuaj të hapur, në mënyrë që të nxiten për të folur për reagimet e tyre.

Nëse nuk ju vijnë fjalët e duhura, vlen shumë një qëndrim miqësor, i cili do të ketë shumë efekt. Në shumë raste, qëndrimi jo me fjalë, por thjesht, me një buzëqeshje, është mjaft domethënës.

Dihet, se në moshat e vogla fëmija përvetëson shumë, në rrugë praktike, me anë të imitimit. Sjelljet e fëmijëve varen shumë nga

sjelljet që ai vëzhgon në familje, në situata të ndryshme (seksualitet, lakuriqësi, programe televizive, fotografi, etj.).

Dihet, se procesi i shoqërizimit u ka dhënë, në një farë mënyre, edukim seksual të gjithë fëmijëve, para se ata të shkojnë në shkollë. Është mirë të kujtojmë se këto ndikime nuk mund të “korrigjohen” menjëherë, por në mënyrë të natyrshme dhe të shkallëshkallshme.

Shtypi, radioja, televizioni, filmat dhe, më vonë, grupi i bashkëmoshatarëve luajnë rol të rëndësishëm në formimin e tyre.

Në këto kushte roli i shkollës dhe, në mënyrë të veçantë, i mësuesit është mjaft i rëndësishëm. Ata ndihmojnë fëmijët për të përballuar në mënyrë kritike këto ndikime.

Programimi i një tematike për edukimin seksual, në kurrikulën shkollë të ciklit fillor, do të ndihmojë fëmijët që të marrin përgjigje për shumë pyetje që ata kanë në këtë drejtim.

Mësuesi duhet të jetë i vëmendshëm dhe i kujdesshëm në pyetjet, interesat e fëmijëve dhe, ajo që është më e rëndësishme, për llojin e përgjigjes që duhet të jepet.

Para se të nisë punën me fëmijët, në fushën e edukimit seksual mësuesi duhet të organizojë takime me prindër, për të paraqitur njohuritë dhe materialin didaktik që do të zhvillohet me nxënësit.

Idetë që do të realizojmë me nxënësit janë:

- Qeniet e gjalla lindin nga qeniet e gjalla.
- Çdo krijesë lind nga një krijesë tjetër e ngjashme me të.
- Të vegjëlit e njeriut zhvillohen tek nëna, para se të lindin.
- Lindja dhe rritja e njeriut.

Gjatë zhvillimit të kësaj tematike, nxënësit mund të bëjnë mjaft pyetje. Më poshtë, po japim disa prej tyre dhe sugjerime për përgjigje të mundshme, të cilat janë alternativa që mësuesi mund t'i përdorë në përputhje me mjedisin shoqëror ku ai jeton, në marrëveshje dhe me miratimin e prindërve.

- Ku rriten bebet?
(Në një vend special të barkut të nënës, që quhet **mitër**.)
- Për sa kohë qëndron fëmija në barkun e nënës?
(Nëna mban në **mitër** fëmijën, i cili rritet për nëntë muaj.)

- Po unë, a kam lindur nga një vezë?
(*Po, veza ishte në barkun e nënës tënde. Kjo vezë është shumë- shumë e vogël.*)
- Si fillojnë të rriten vezët?
(*Është e nevojshme që fara e babait, të bashkohet me vezën e nënës, që kjo më pas, të fillojë të rritet.*)
- Si ushqehen fëmijët në barkun e nënës?
(*Ushqimi vjen nëpërmjet gjakut të nënës. Ai arrin tek fëmija nëpërmjet një tubi të veçantë të quajtur kordoni kërthizor. Pika në mes të barkut tënd, në të cilën ngjitet kordoni kërthizor, quhet **kërthizë**.)*)
- Si lind fëmija?
(*Muskujt e mitrës shtyjnë fëmijën jashtë trupit të nënës.*)
- Përse fëmija lind kokëposhtë?
(*Sepse kështu ai del jashtë (lind) më lehtë.*)

Gjatë përgjigjeve, mësuesi do të bëjë kujdes në përzgjedhjen e fjalëve. Në përgjithësi, prirja është për të përdorur terma shkencorë. Ndërkohë, mësuesit duhet të kenë parasysh se fëmijët vijnë në shkollë me një fjalor, shpesh të ndryshëm, për pjesët intime të trupit të tyre. Kjo terminologji është në përputhje me mjedisin shoqëror dhe rajonal të fëmijës, që duhet të kihet në konsideratë, edhe kur këto terma nuk janë të përshtatshëm, sipas mendimit të mësuesit.

Prandaj, mësuesi duhet të gjejë mënyrën më të mirë për të modifikuar shkallë – shkallë këtë fjalor vetjak, me një gjuhë të përbashkët dhe të pranueshme, në fund të fundit, për të lehtësuar diskutimet e mëtejshme për riprodhimin seksual.

Përdorimi i librave të përshtatshëm, në formë tregimi, do të jetë një ndihmë e madhe për mësuesit.

Gjithashtu, me mjaft rëndësi, në këtë kapitull, është dhe lidhja e këtyre problemeve me përvojat e jetës së tyre në familje.

Ky aspekt diskutohet me detaje në kapitullin për familjen, në lëndën e edukatës qytetare. Ftohen mësuesit të përdorin idetë e tyre, të çfarëdo lloji që atyre u duket e arsyeshme, sipas situatave të veçanta që mund të kenë në klasë, në procesin e edukimit seksual.

Përsëri në ndihmë të mësuesit

ABUZIMI SEKSUAL

Çfarë është abuzimi seksual

Abuzimi seksual është kryerja e kontaktit seksual, pa pëlqimin e njërit apo partnerët.

Inçesti

Kjo formë e abuzimit është problem serioz. Në këto raste, kemi të bëjmë me një marrëdhënie të fshehtë, nga që i mituri, i cili është viktimë e abuzimit, është i shtrënguar dhunshëm ta mbajë të fshehtë këtë gjë. Fëmija e ruan këtë të fshehtë nga frika se mos abuzuesi lëndon anëtarët e tjerë të familjes. Inçesti mund të ndodhë në çdo familje. Mundësia më e madhe është në ato familje ku prindërit janë përdorues të alkoolit, të drogës, kur marrëdhëniet midis bashkëshortëve janë të këqia apo kur njeri nga fëmijët merr përsipër rolin e prindit që mungon, që është i sëmurë ose i vdekur. Cilado qofshin faktorët, këshillat që mund t'u jepen viktimave, janë shumë të dobishme.

Pedofilia

Pedofilia ka të bëjë me ngacmimet e karakterit seksual që u bëhen të miturve. Më konkretisht, ka të bëjë me veprimtarinë seksuale midis një të rrituri dhe një mituri, që nuk kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin. Ajo mund të përfshijë ose jo përdorimin e forcës dhe prostitucionin. Në raste të kësaj natyre, zakonisht kemi të bëjmë me ledhatime të organeve gjenitale të njërit person. Pedofilia, ashtu si inçesti, mund t'u shkaktojnë fëmijëve dëme të ndjeshme, si fizike, ashtu edhe psikike. Këshillimi është i dobishëm dhe i domosdoshëm.

Përdhunimi

Me përdhunim kemi marrëdhënie seksuale, kundër dëshirës së njërit nga personat pjesëmarrës në akt. Kjo gjë mund t'i ndodhë si meshkujve, ashtu dhe femrave. Lëndimi mund të jetë si fizik, ashtu dhe psikik. Përdhunimi mund të ndodhë midis të panjohurve, miqve etj. Përdhunimi, shpesh, është akt zemërimi, një përpjekje për të ushtruar dhunë, pa përfituar kënaqësi. Ndihma që mund t'u jepet viktimave, qoftë edhe me këshilla, është tepër e rëndësishme.

Parandalimi i abuzimit seksual

Të flasësh natyrshëm për seksualitetin, është thjesht, një mënyrë mjaft e mirë për të bërë një përpjekje në parandalimin e abuzimeve seksuale.

Kur analizuar problemin e prekjeve, kishim për qëllim që fëmija të dallojë prekjen e pëlqyeshme a të mirë nga ajo e papëlqyeshme dhe abuzive.

Ka rëndësi që, qysh në moshë të vogël, fëmija të dijë se trupi i tij i takon atij vetë, se ka të drejtë të thotë **jo** dhe se mund të flasë për çfarë ndjen me prindërit apo me njerëzit tek të cilët ka besim. Qëndrimi juaj, në këtë drejtim, ka shumë rëndësi. Pikërisht, ky qëndrim do të bëjë që fëmija të jetë i hapur me ju, apo do ta mbajë vetë peshën e të fshehtave të tij. Këtu nuk është fjala që t'i fusësh panik dhe frikë fëmijës, por për ta vënë në dijeni për ekzistencën e këtyre të vërtetave.

Besojmë se, në qoftë se fëmija arrin të dallojë se çfarë është e mirë për të, nga ajo se çfarë nuk është e mirë, ai do të jetë në gjendje të ushtrorë lirinë e vet dhe t'i bëjë të tjerët ta respektojnë.

KËSHILLA

SI DUHET REAGUAR, KUR NJË FËMIJË KA PËSUAR NJË ABUZIM SEKSUAL

E PARA: DËGJO!

Shko me fëmijën në një vend disi të veçantë dhe pyete atë të tregojë me fjalët e veta, se çfarë ka ndodhur.

Përgatitu të kuptosh dhe të përdorësh terminologjinë që përdor fëmija.

Skicat dhe vizatimet mund të ndihmojnë fëmijën për të ilustruar atë çfarë ka ndodhur.

Kujdes: deklaratimet që bën fëmija duhen dëgjuar me kujdes !

E DYTA

Siguroni fëmijën, se ju e dini, se nuk është faji i tij për atë që ka ndodhur.

E TRETA

Siguroni fëmijën, se ju vjen keq për çfarë ka ndodhur.

E KATËRTA

Mos shfaq asnjë dyshim.

E PESTA

Merreni pohimin e fëmijës seriozisht.

Nxiteni fëmijën për t'ju treguar gjithçka.

KUJTONI !

Nxitja e fëmijës për të qenë i hapur me ju, kërkon përqëndrim në dëgjimin me kujdes të asaj që fëmija thotë, në thithjen e asaj që thuhet dhe në vlerësimin objektiv të fjalëve të fëmijës.

Kujdes, vlerësoni objektivisht fjalët e fëmijës !

Gjatë bisedës, mos dyshoni dhe mos paragjykoni asgjë nga ato që thotë fëmija, sepse kjo nuk do të ndihmonte në zbulimin e realitetit.

Duhet të jemi të kujdesshëm dhe të vëmendshëm, sidomos në vlerësimin e pohimeve që fëmija bën. Gjithashtu, duhet treguar kujdes në ekzaminimin e pohimit apo, si dhe në rastet kur fëmija, më vonë, nuk e pranon pohimin e tij.

Në qoftë se një deklaratë fillestare hidhet poshtë nga fëmija, ajo mund të ketë qenë plotësisht e bazuar, por, ndërkohë, mohimi meriton plotësisht të merret në konsideratë.

Rekomandohet që deklaratimet e një fëmije, për abuzim seksual, duhen marrë seriozisht, por, ndërkohë, ato nuk duhet të merren, patjetër, si të vërteta, por të ekzaminohen, para se të veprohet më tej.

E GJASHTA: Afirmo ndjenjat e fëmijës!

Fëmijët, që janë viktima, mund të kenë një mori ndjenjash, si: mërzitja, frika, ankthi, depresioni, etj.

Kujto, një dhe vlerëso se çfarë ndjenjash ka fëmija dhe mos bëj përpjekje për t'i treguar fëmijës se si duhet të ndjehet ai.

SHMANG!

- **Mos e pyet asnjëherë fëmijën se si ndodhi sulmi.**
- **Mos pyet asnjëherë “pse”.**
- **Mos pyet “kush e bëri”.**
- **Mos u përpiqni të identifikoni fajtorin.**
- **Mos u bëj gjygtar rreth informacionit që jep fëmija.**
- **Mos paragjyko se ajo përvojë ishte e keqe apo e dhimbshme; sepse ajo mund të ketë qenë neutrale ose deri dhe e pëlqyeshme për fëmijën.**

E SHTATA: Merr një vendim !

Informo organet kompetente për të gjithë informacionin që ju dini nga fëmija rreth abuzimit seksual.

E TETA: NDIHMONI FËMIJËN !

Është e rëndësishme që ju të njoftoni çdo rast sulmi të dyshuar në institucionet përkatëse për mirërritjen e fëmijës, për

mbrojtjen tuaj dhe të fëmijëve të tjerë (në polici apo në institucione të tjera, që merren me këto probleme).

Mbani mend se të gjitha deklaratimet duhet të trajtohen seriozisht. Konfidencializmi apo ruajtja e fshehtësisë së personit që njofton duhet të respektohet.

Incidentet nuk duhet të diskutohen me asnjëri që nuk ka përgjegjësi për zgjidhjen e problemit.

SI MUND T'Ë PËRGJIGJEMI PYETJEVE TË FËMIJËVE

Si bëhet dashuri?

Është e vështirë të realizojmë një diskutim shkencor për këtë problem, apo ta përmbledhim me një fjalë apo frazë.

Kështu mund të shprehemi:

- Duhet bërë dashuri. Kjo ndodh midis të rriturve. Ata që bëjnë dashuri nuk janë të një gjaku. *Dashuri nuk duhet të bëjmë kur jemi fëmijë dhe nuk duhet të detyrojmë askënd të bëjë dashuri.*

Si bëhen bebet?

Një burrë dhe një grua bëjnë dashuri. Babi vendos një kokërr gruri tek mami. Kjo gjë, në moshën 4 vjeç, harrohet, dhe më pas rreth moshës 5 apo 6 vjeç duhet saktësuar, siç do ta shpjegojmë më poshtë.

Dukuria që rrethon lindjen, gjithmonë, bën te fëmijët shumë përshtypje. Fëmijës i pëlqen të dëgjojë të flitet për këtë ngjarje. Kur prindi ose edukatori bën shpjegime të kuptueshme, fëmija kupton se ku ndodhet dhe se nga vjen.

Shumë e rëndësishme është që etapat të mos fshihen, në mënyrë që fëmija të kuptojë gjithë rrjedhën e ngjarjeve, si: dashuri midis burrit dhe gruas, ngjizja ose fekondimi, zhvillimi i fetusit (bebes) dhe lindja.

Për të rriturit, pjesa më e vështirë për t'u trajtuar është etapa e fekondimit, sepse ajo ngatërron nocionin e kënaqësisë, me aktin seksual.

Të bësh fëmijën të flasë mbi mënyrën se si e përfytyron jetën e tij në barkun e nënës, lindjen e tij, mund të jetë një ushtrim zbavitës dhe plot intimitet.

Shumë fëmijë i shohin prindërit, e tyre të seksit të kundërt, si të dashurit e tyre; shpesh ata thonë: “Unë do të martohem me babin”. Fëmija do ta kuptojë, gradualisht, se prindërit e tij formojnë një çift. Kështu ai do të heqë dorë nga kjo dashuri dhe do të kërkojë marrëdhënie të reja. Përpyekja për pavarësi shfaqet që në lindje.

Pse vajzat nuk kanë bibilush?

Është mjaft e rëndësishme të dihet se fëmija pëlqen që të identifikojë apo njëjtësojë pjesët e trupit të tij. Kështu, në qoftë se ne si prindër apo edukatorë nuk përjashtojmë organet gjenitale, nga pjesët e tjera të trupit, fëmija do ta jetojë, natyrshëm, veçantinë e vet seksuale, në kuadrin e gjithë zhvillimit të tij.

Termet e saktë, për të emërtuar organet gjenitale, mësohen po aq lehtë, sa dhe epitetet përkëdhelëse si “rrushi”, “zogu” etj.

Kur fëmijët pyesin: “Pse vajzat nuk kanë bibilush”? është mirë që të saktësohet se vajzat kanë diçka tjetër, sepse ndodh që, shpesh, prindërit apo edukatorët kanë prirje, që, pa e kuptuar ta emërtojnë vajzën me atë që ajo nuk e ka. Për shembull, “*Ti je vajzë, sepse nuk ke bile*”. Ky shpjegim është i gabuar, madje mund të luajë edhe rol negativ, sepse bën që fëmija të ndiejë një mungesë. Është mirë që termet të jenë pozitive dhe të forcojnë identitetin seksual, në formim e sipër. Për shembull, “*Ti je vajzë dhe ti ke vezore, vaginë, etj. Ti je një djalë dhe ke bile, testikula, etj.*”

Periudha nga 0 deri në 6 vjeç është vendimtare për zhvillimin dhe forcimin e identitetit seksual. Gjuha e pasuron apo e varfëron perceptimin që ka fëmija për veten e tij, vajzë apo djalë qoftë.

Pse nuk mund të fle me ty?

Sepse unë kam zgjedhur babin për të fjetur dhe të rriturit nuk duhet të flenë me fëmijët. Ti, kur të rritesh, do të zgjedhësh për të fjetur atë që do të dëshirosh.

Pse nuk mund të prek bibilushin tim?

Fëmija duhet bindur se nuk duhet prekur, sidomos në prani të të tjerëve dhe, ajo që është e rëndësishme, askush nuk duhet ta prekë. Duhet mënjanuar «thëniet: po vazhdove kështu bibilushi yt do të rritet», apo «do ta presim», etj.

2.1 Qeniet e gjalla lindin nga qeniet e gjalla

Objektivat: Në fund të kësaj teme nxënësit:

- Tregojnë se riprodhimi siguron vazhdimësinë e jetës.
- Do të tregojnë, me shembuj, se çdo qenie e gjallë lind nga një qenie tjetër e gjallë.

Forma pune: Diskutim i lirë, kompozime, punë në grupe, vizatime.

Mjetet: foto të familjes (të nxënësit vetë, mamit, babit, gjyshes, gjyshit, motrave apo vëllezërve, ose figura të kafshëve të ndryshme, me pasardhësit e tyre), lapsa me ngjyra, letër për të vizatuar, ngjitime.

Organizimi i mësimit

Hapi i parë

Në fillim, u kërkohet nxënësve që të tregojnë ndonjë ngjarje, që mund të ketë ndodhur në familjen e tyre; për shembull, një bebe e lindur në familjen e tyre apo tek të afërmit; ose dhe lindja e ndonjë kafshe shtëpiake.

Më pas, kërkohet nga fëmijët që të tregojnë ndonjë ndodhi që të kanë lexuar në lidhje me lindjen e një bebi, apo të ndonjë kafshe shtëpiake.






Një veprimtari e tillë mund të sjellë, pa shumë vështirësi, që të flitet për fëmijët dhe nevojat e tyre.

Hapi i dytë

Pas këtyre veprimtarive mësuesi e ndan klasën në grupe dhe i udhëzon nxënësit të vëzhgojnë fotot ose figurat që ata i kanë sjellë,

paraprakisht, me porosi të mësuesit. Mësuesi udhëzon që ata të jenë të vëmendshëm për të njëjtësuar pasardhësit identikë me prindërit e tyre. Me fotot e familjes, së tyre ata mund të ndërtojnë pemën gjeneologjike të familjes, duke i ngjitur ato në një karton apo letër, sipas prejardhjes.

Nxënësit mund t'i presin fotot e kafshëve të ndryshme ose t'i vizatojnë ato vetë dhe t'i ngjisin në kartona apo në një letër të zakonshme.



I kujt është i vogli ?

Në këtë fazë të zhvillimit të tyre, fëmijët janë mjaft entuziastë që të krijojnë lidhje ndërmjet gjallesave të vogla dhe prindërve të tyre përkatës. Ju mund të organizoni një lojë të thjeshtë, me figura të ndryshme, që paraqesin familje kafshësh, duke kërkuar që të vegjëlit të korrespondojnë me prindërit e tyre. Këto veprimtari jo vetëm pasurojnë fjalorin e nxënësve, por i aftësojnë ato që të klasifikojnë, të numërojnë, të vizatojnë dhe të shkruajnë.

Është mirë që punimet e nxënësve, me figura kafshësh të varen në muret e klasës, duke përfshirë dhe qeniet njerëzore, si dhe të vegjëlit e tyre. Kjo mënyrë është shumë efikase për të vënë në dukje punën e nxënësve, si dhe për t'i nxitur ato për kërkime të mëtejshme.

Diskutimet e lira, me siguri, do t'i bindin nxënësit se gjallesat e vogla lindin nga e njejta me to.

Vlerësimi

Nga vëzhgimet që bën mësues, i gjatë punës në grupe, si dhe nga përfundimet në të cilat arrijnë nxënësit, vlerëson se ata kanë arritur në përfundimin se qeniet e gjalla lindin nga vetë qeniet e gjalla. Në këtë mënyrë, ata, tashmë, janë përgatitur për të kuptuar temën pasardhëse.

2.2 Çdo gjallesë lind nga një gjallesë tjetër e ngjashme me të

Objektivat: Në fund të kësaj temë, nxënësit:

- Do të tregojnë me shembuj se, në disa gjallesa, të vegjël lindin nga vezët dhe, disa të tjerë drejtpërdrejt nga nëna e tyre.
- Do të nxiten për të pasuruar fjalorin me termat e nevojshme, të shpjeguara në hyrje të kapitullit.
- Do të nxiten të kuptojnë se bebi (embrioni ose fetus) është i gjallë dhe lëviz në barkun e nënës.

Forma pune: vizatim, klasifikim, diskutim, lojë.

Mjetet: figura të gjallesave të ndryshme dhe të pasardhësve të tyre, gërshërë, fletë të bardha, ngjitëse.

Organizimi i mësimit

Hapi i parë

U kërkoni nxënësve të sjellin shembuj për ato kafshë që i lindin të vegjël përmes vezëve dhe, më tej, për ato kafshë që i lindin të vegjël nga nëna e tyre.


Fëmijët mrekullohen nga lindja dhe të porsalindurit; disa prej tyre mund të kenë njohuri për mënyrat se si lindin të vegjël e gjallesave të ndryshme (më e lehtë kjo është në fshat). (Përdorni figurat e fletës së punës ose të tjera të sjellë nga nxënësit.)

Hapi i dytë

Cila është nëna e tyre?

Një ekspozitë me figura, vizatime ose fotografi të disa gjallesave të ndryshme dhe të vegjëlve të tyre mund të përdoret që të nxisë njohjen e nxënësve me dy mënyrat e të lindurit, për të cilat folëm më lart.





Hapi i tretë

Të vegjëlit zhvillohen tek nëna, përpara se të lindin.

Vëmendja e nxënësve, për këtë fakt, përqëndrohet tek figurat e fletës së punës (të përdoret fleta e punës në të cilën ka disa figura të lopës, qenit dhe të një gruaje). Sqarohen nxënësit se, të gjitha këto nëna, janë në pritje të të vegjëlvë të tyre. Ata ndodhen brenda uterusit (mitrës) së tyre. Fëmijët mrekullohen nga fakti që embrioni (fetusi) është i gjallë dhe ai lëviz. Nxënësit mund t'i presin figurat dhe t'i grupojnë, duke i ngjitur njeri pas tjetrit, sipas llojit dhe shkallës së zhvillimit, si në figurë.

Por nxënësve, gjatë këtij aktiviteti mund t'u lindin disa pyetje:

1. Si ushqehen fëmijët në mitër?
2. Përse fëmijët janë me kokë poshtë?
3. Sa kohë qëndrojnë brenda trupit të nënës?

Vlerësimi

Në bazë të punës që realizojnë nxënësit në fletën e punës, mësuesi bën vlerësimin e arritjes së objektivave.

2.3 Si bëhen fëmijët

Objektivat: Në fund të kësaj teme, nxënësit:

- Do të kuptojnë se, për të bërë një fëmijë, duhet një burrë dhe një grua.
- Do të pasurojnë fjalorin me terma, si: veza e nënës etj.
- Do të mësojnë se fëmija duhet të qëndrojë nëntë muaj në barkun e nënës që të rritet.

Forma pune: shpjegim, diskutim, vëzhgim.

Mjete: fletë pune

Organizimi i mësimit:

Informacion për mësuesin

Mësuesit dhe prindërit, gjithmonë, janë në ankth, kur fëmijët pyesin “Si bëhen fëmijët”. Pra kur ata mendojnë se si të shpjegojnë aktin e riprodhimit, në mënyrë që të mos keqkuptohen nga fëmijët.

Është e nevojshme që mësuesi të përdorë terma të thjeshtë dhe të kuptueshëm. me nxënësit. Që në fillim mësuesi duhet të bëjë të qartë, se për të filluar një fëmijë, duhet një burrë dhe një grua (mundet që ndonjë nga nxënësit ka marrë informacion për formimin e “bebes në epruvetë”; mësuesi duhet të ndërhyjë, duke thënë se këtë gjë do ta mësoni më vonë).


Shpjegimet duhet të jenë të thjeshta. Për shembull, një burrë dhe një grua, kur janë bashkë, e ndjejnë veten mirë, bëjnë dashuri (shtrëngohen fort me njëri - tjetrin dhe të dy provojnë një kënaqësi të madhe). Në thelb përgjigjja e pyetjes “Si bëhen bebet” qëndron në bashkimin e farës së babait me vezën e nënës. Embrioni më pas rritet, ngadalë, për nëntë muaj, në barkun e nënës. Në këtë mënyrë kemi dhënë origjinën e lindjes së një fëmije.

Nxënësit janë të befasuar nga farat e rritjes dhe të madhësisë së fëmijës në etapat e ndryshme të rritjes së tij.

Hapi i parë

Për të konkretizuar një gjë të tillë, ju mund të përdorni figura, postera, si dhe libra të përkthyer në gjuhën shqipe, të cilët tregojnë aktin e fekondimit, si dhe etapat e zhvillimit të fëmijës në barkun e nënës.

Mund të kërkonti ndihmë në **Qendrën e shëndetit publik** të qarkut tuaj ose mund të bëni një vizitë atje, me nxënësit tuaj, duke kërkuar ndihmë jo vetëm për mjete në këtë qendër, por dhe të personelit mjekësor.



Si bëhen fëmijët

2.4 Si rriten fëmijët

Objektivat: Në fund të kësaj teme, nxënësit :

- Do të nxiten të kuptojnë se fëmijët, që të rriten, kanë nevojë për dashuri dhe përkujdesje.
- Do të nxiten të bashkëpunojnë me familjen në sigurimin e informacioneve të ndryshme rreth moshës kur kanë filluar të zvarriten, kur kanë filluar të ecin, kur u ka dalë dhëmbi i parë, etj.
- Do të argumentojnë se për t'u rritur është i domosdoshëm ushqimi dhe gjumi.
- Do të tregojnë ndryshimet tek fëmijët, ndërsa rriten.

Forma pune: diskutim, plotësimi i fletëve të punës, grumbullimi i informacionit, braingstorming (stuhi mendimesh), lojë.

Mjete: fletë pune, fotografi të nxënësve të vegjël (album me fotografi)

Organizimi i mësimit

Informacion për mësuesit

Dashuri dhe përkujdesje, kush ua jep fëmijëve këto. Është shumë e rëndësishme që mësuesit, përpara se të përballen me këtë argument, të marrin në konsideratë dhe të vlerësojnë efektet e mundshme, të situatave të ndryshme në klasë. Ndodh që në klasën tuaj të keni fëmijë të cilët rriten në situata të ndryshme shoqërore, të kenë përkatësi të ndryshme racore. Po kështu disa mund të kenë një familje të rregullt, disa të tjerë mund të rriten nga gjyshërit, tezet, hallat, xhaxhallarët etj. Është e rëndësishme që fëmijët të mos mendojnë për bërthamën familiare të përbërë nga dy prindërit si e vetmja situatë familiare, e drejtë. Përndryshe, është e rrezikshme që disa fëmijë të ndjehen jo mirë në këtë situatë dhe të gjenden në vështirësi për t'u njëjtësuar në shembujt e dhënë.

Hapi i parë

Diskutoni me nxënësit se si kujdesen të afërmit e tyre për ta. Ky problem do të rimerret edhe një herë në klasën e tretë dhe të katërt, në kapitullin “Çfarë më ndihmon të rritem”.

Mund të organizoni, me nxënësit tuaj, dhe një diskutim, mbasi keni lexuar tregimin e mëposhtëm.

Fqinjët e Adës kanë një bebe të porsalindur.

Bebja e porsalindur ka gjithçka për të cilën ai ka nevojë, thotë Ada.

Ka një karrocë të re, krevat, veshje të reja, vaskë për larje dhe shumë gjëra të tjera.

Udhëzoni nxënësit të mendojnë për gjëra të tjera, për të cilat ka nevojë një bebe i porsalindur dhe, më pas, bëni vlerësimin.

Hapi i dytë

Për çfarë tjetër kanë nevojë fëmijët?

Për ushqim dhe gjumë. Diskutoni me nxënësit, duke kujtuar njohuritë që ata kanë marrë në klasën e parë për gjumin dhe ushqimin. Sa dhe Kur fëmijët kanë nevojë për të ngrënë dhe për të fjetur?

Mësuesi duhet të ketë kujdes që diskutimin ta drejtojë edhe në pikat që kanë si përgjigje pohimet që janë dhënë më poshtë:

- Qumështi është për të gjithë fëmijët e vegjël, por edhe për gjitarë të tjerë si macja, qeni, qengji, etj.
- Çdo gjallesë e vogël është në gjendje të thithë, që nga çasti i lindjes.
- Bebet, pas lindjes, thithin qumështin nga gjiri i nënës.
- Një shishe me biberon, që është i ngjashëm, në formë, me gjirin e nënës, përdoret, ndonjëherë, për të ushqyer fëmijët.

Hapi i tretë

Ndryshimet tek fëmijët, ndërsa rriten

Për të realizuar këtë veprimtari organizojmë me fëmijët lojën “Imagjinoni cili është?”

Udhëzohen nxënësit të sjellin në klasë fotografi të moshës kur kanë qenë të vegjël (foshnje) (mund të përfshihen dhe fotografi të

mësuesve). Kërkojuni nxënësve që të mos ua tregojnë fotot e tyre nxënësve të tjerë në klasë.

Vendosuni fotove nga një numër.

1 2 3

4 5

6 7 8

Nxënësit do të përpiqen të gjejnë se cili është.

Në fund të temës, nxënësve u jepet detyrë që të plotësojnë në shtëpi, në bashkëpunim me prindërit apo të afërmit, fletët e punës që kërkojnë të jepen të dhëna të tilla si: kur fëmijët kanë filluar të ecin, pesha e lindjes, etj. gjithashtu u jepet edhe fleta e dytë, me temë “Ndryshimi i jetës sime”.

3. SI TË KUJDESEMI PËR VETEN

Hyrje

Kapitulli plotëson kulturën e nxënësve për t'u kujdesur për veten. Theksi vihet në rolin e zbatimit të rregullave të përgjithshme të higjienës, kujdesit për të shmangur sëmundjet, zbatimit të regjimit ditor, të higjienës së dhëmbëve, etj.

3.1 Higjiëna vetjake

Objektivat: Në fund të kësaj teme, nxënësit:

- Do të shpjegojnë termin **vaksinim** dhe ilaçe apo barna mjekësore.
- Do të thonë disa rregulla të thjeshta për higjienën vetjake.

Mjetet: Një figurë ku tregohet larja e duarve.

Forma pune: Punë në grupe, bashkëbisedim, veprimtari praktike.

Organizimi i mësimimit

1. Sot mungon X . Ai është i sëmurë me grip. E dini se gripi përhapet nga viruse? Sëmundjet përhapen nga viruset apo bakteriet, që janë shumë të vegjël sa nuk dallohen me sy.

Ato mund t'i shohim vetëm me nje aparat që quhet **mikroskop**.

Bakteriet, shkaktojnë ftohjen, skarlatinën, fruthin e shumë sëmundje të tjera.



2. Për t'u ruajtur nga bakteriet, duhen marrë disa masa mbrojtjeje p.sh.: Larja e duarve, sa herë ato ndoten, sidomos para ngrënies dhe pas daljes nga banja.
 - Ndenja në mjedise të pastra.
 - Qëndrim larg njerëzve të sëmurë, me sëmundje ngjitëse.
 - Mbrojtja e ushqimeve sidomos nga mizat.
 - Tregohet konkretisht, në bazë të grupeve:
 - a) larja e duarve
 - b) përdorimi i shamisë, në rast teshtitjeje apo kolle.
3. Flitet për vaksinimin si mënyrë për të parandaluar sëmundje të ndryshme. Ju keni bërë disa vaksina. Ato do t'ju mbrojnë nga disa sëmundje ngjitëse.

Ilaçet apo barnat mjekësore merren kur jemi të sëmurë dhe vetëm me rekomandimin e mjekut dhe praninë e prindërve. Më pas drejtohet pyetja: Thoni disa ilaçe apo barna mjekësore që keni përdorur. Në fund bëhen vlerësimet në bazë të realizimit të objektivave të dhëna.

3.2 Dhëmbët e mi

Objektivat: Në fund të kësaj teme, nxënësit:

- Do të thonë, me fjalët e tyre, funksionet e dhëmbëve.
- Do të dinë të përmendin dhe zbatojnë mënyrat e mbrojtjes së dhëmbëve (ato kryesore).
- Të demonstrojnë mënyrën më të saktë të larjes së dhëmbëve.

Mjetet: Furçe dhëmbësh, pastë dhëmbësh, figura që paraqesin dhëmbët e shëndoshë e të dëmtuar, mollë e karrota.

Forma pune: Punë në grupe, bashkëbisedim, veprimtari praktike

Organizimi i mësimit

1. a) Vihen nxënësit në një situatë për të qeshur. Pyeten:

- Çfarë shihni tek fytyra e shokut që po buzëqesh ?

Dhëmbët. Ata shërbejnë për përmirësimin e pamjes.

b) Kafshoni mollën ose karotën që keni në dorë. Çfarë shihni në pjesën e mbetur? (Shihni shenjat e dhëmbëve ?)


- Pra, dhëmbët shërbejnë për të kafshuar e përlypur ushqimin.
- Fëmijët, kur lindin, nuk kanë dhëmbë.
- Ato i dalin më pas, prandaj, fëmijët e vegjël pinë qumësht dhe nuk hanë ushqime të forta.
- Shihni shokun që keni përpara.
- A i ka rënë ndonjë dhëmb?
- Po i del ndonjë i ri?
- Në moshën pesëvjeçare, dhëmbët fillojnë të bien. Në vend të tyre dalin të tjerë, që janë të përhershëm.

c) Shqiptoni disa fjalë.

Në disa bashkëtingëllore kërkohet përdorimi i gjuhës, i dhëmbëve dhe i buzëve.


- Duke shqiptuar fjalë të ndryshme apo duke fishkëllyer vërehet edhe rëndësia e dhëmbëve. Për të vënë në dukje, rëndësinë e dhëmbëve këkohet shqiptimi i të njëjtës fjalë, nga nxënës që u mungojnë disa dhëmbë.

Beni nuk i lan dhëmbët




Dhëmbët e Benit

Gimi i lan rregullisht




Dhëmbët e Gimit




Furçë jo e rregullt


Mënyrat e larjes së dhëmbëve



1



2



3

Furçë e rregullt

2. Disa dhëmbë lëvizin. Disa ju dhëmbin. Këtyre të fundit u ka filluar prishja ose, në gjuhën mjekësore, *karjesi*. Janë disa bakterie që prishin dhëmbët. Për të ruajtur dhëmbët nga prishja, është e rëndësishme pastërtia e gojës.
3. Mënyra e larjes së dhëmbëve.
Disa i lajnë dhëmbët rregullisht. E rëndësishme është larja në mëngjes, para ngrënies, pas ngrënies dhe në darkë. E mirë është larja pas çdo ngrënie, sepse mbeturinat e ushqimit prishin dhëmbët.
4. Tregohet me veprime konkrete larja ashtu siç quhet larja e dhëmbëve.
Përdorimi i furçës. Furça duhet të jetë me qime të drejta. Ajo mbahet në fund të bishtit dhe, pasi vendoset pasta e dhëmbëve, bëhen lëvizje të vogla rrethore nga lart poshtë dhe poshtë lart, në sipërfaqen e jashtme dhe të brëndshme të dhëmbit, deri në skajin më të fundit të gojës.
Kërkohet nga secili kjo mënyrë larjeje.
Theksohet që larja sistematike është e rëndësishme, por kujdes duhet treguar edhe në ngrënien e ushqimit . Sheqeri i shumtë i dëmton, kurse frutat i ndihmojnë dhëmbët për të qënë të shëndetshëm.
Vizita tek dentisti na ndihmon që dhëmbët t'i ruajmë e t'i mjekojmë në kohë.
Bëhen vlerësimet duke parë përvetësimin e objektivave të caktuara.

3.3 Regjimi ditor

Objektivat: Në fund të kësaj teme, nxënësit:

- Do të thonë, me fjalët e tyre, ecurinë gjatë një dite shkollore.
- Do të argumentojnë, përse duhet zbatuar një regjim ditor.

Mjetet: Figura ku tregohen veprime gjate ditës

Forma pune: Bashkëbisedim, veprimtari praktike, punë në grupe

Organizimi i mësimit

1. Secili nga ju zgjohet vetë ose nga dikush. Pasi zgjoheni, ju bëni të njejtat veprime, për t'u përgatitur për në shkollë.
Ju jeni ndarë në grupe.


Grupi i parë të tregojë veprimet: *Në shtëpi, në mëngjes.*

- Zgjimi e dalja nga krevati.
- Vajtja në tualet.
- Larja e dhëmbëve, fytyrës, qafës dhe duarve.
- Veshja dhe krehja.
- Ngrënia e mëngjesit.
- Përgatitja për në shkollë.


Grupi i dytë të tregojë: *Vajtjen në shkollë e qëndrimin në të.*

Në këtë grup theksohet kujdesi në rrugë, ruajtja nga rreziqet e mundshme (ky problem të trajtohet shkurt, sepse do të rimerret në fund të klasës së dytë).


Nxënësi do të vendosë numrat sipas radhës së veprimeve




Grupi i tretë të tregojë: *Kthimin në shtëpi deri në momentin e gjumit.*




- Kthimi në shtëpi.
- Zhveshja.
- Larja dhe higjiena vetjake.
- Ngrënia.
- Ndhurma në shtëpi.
- Përgatitja e mësimëve.
- Loja argëtuese apo koha e lirë.
- Fjetja, jo më vonë se ora 21⁰⁰.



Bebet duhet të fletë shumë sepse rriten shpejt



Edhe ju keni nevojë të flini sepse dhe ju rriteni shpejt



Ndërsa kur të rriteni duhet të shkoni për të fjetur më vonë

Pasi secili grup demonstroi veprimet përkatëse, theksohet se alternimi i punës me pushimin, si dhe zbatimi i këtyre veprimeve, sipas radhës, na jep mundësi të kemi kohë të lirë e shëndet të mirë.

Bëhet vlerësimi, duke parë përvetësimin e objektivave të dhëna, si dhe plotësimin e fletës së punës numër 11.